



Prishtinë, më 27.06.2019

KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN

VENDIM

Nr 3, datë 27.06.2019

KOMISIONIT TË PËRBASHKËT PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE PËR DIASPORËN

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për koordinimin me qëllim miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 23.03.2015 e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë; Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë” si dhe Urdhërit të Ministrit të Shtetit për Diasporën, nr . 12 datë 21.05.2019, Komisioni i Përbashkët për Miratimin e Teksteve për Diasporën, pasi diskutoi sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Shqyrtimin në parim të Rregullores së Komisionit dhe rishikimin dhe harmonizimin e saj;
2. Shpalljen e konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën, jo më larg se data 1 nëntor 2019;
3. Përgatitjen e Draft-Standarteve për tekstet e diasporës brenda datës 23 korrik 2019, në mbledhjen e paracaktuar në Vlore (21-23 Korrik 2019).
4. Përfundimin e dokumentacionit të konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 15 tetor 2019;

5. Miratimin i dokumentacionit të konkursit për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën nga Ministrat përgjegjës deri më 25 tetor 2019;
6. Mbylljen e aplikimeve për konkursin për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën në datë 4 Maj 2020;
7. Përfundimin e vlerësimit të aplikimeve për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 1 Qershor 2020;
8. Periudha e ankimit nga aplikantët nga 1 deri më 15 qershor 2020;
9. Shpallja përfundimtare e tekstit fitues për nivelin e parë të tekstit të përbashkët për diasporën brenda datës 18 Qershor 2020.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Kryetar:

Z. Nuhi Gashi



Anëtarët:

1. Z. Valmir Gashi
2. Z. Arbër Salih
3. Zj. Shqipe Gashi-Ramadani
4. Z. Isni Kryeziu
5. Zj. Erida Koleci
6. Zj. Majlinda Hala
7. Zj. Evis Mastori
8. Zj. Anila Ferizaj
9. Zj. Etleva Kondi

